



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË



QENDRA "SHKOLLA E
DREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Nr. 150 Prot

Nr. *2864* Prot. *2025*

Vlorë, *17.10.* 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

&

QENDRES "SHKOLLA E DREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit** sipërfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Qendra "Shkolla e Drejtorëve IAP", **përfaqësuar nga znj. Jola Kepi në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv**.

Me qëllim të bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe kontributit të ndërsjellë të Palëve, me synimin për zhvillimin e aftësive të lidhshme të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar (IAPU) në Shqipëri, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm dhe dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin, palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja")



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1 **Qëllimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" në kuadër të zhvillimit dhe kontributit të ndërsjelltë të Palëve me synimin për zhvillimin e aftësive të lidershipit të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar (IAPU) në Shqipëri.

Neni 2 **Baza ligjore**

Në zbatim të ligjit 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 3 , pika 4 ,germa c.

Neni 3 **Mënyra e Bashkëpunimit**

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" :

- Kjo marrëveshje lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitutionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të palëve që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta apo detyrime ligjore, përveç sa parashikuar në këtë marrëveshje. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk çënojnë apo ndikojnë te të drejtat dhe detyrimet që u burojnë këtyre palëve në këtë marrëveshje nuk çënojnë apo ndikojnë te të drejtat dhe detyrimet që u burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.
- Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin për realizimin e veprimtarive të përbashkëta, në funksion të zhvillimit me sukses të Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për certifikimin e drejtorëve dhe aspirantëve për drejtorë të I.A.P.



Neni 4 Detyrimet e palëve

Qendra “Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”, merr përsipër :

- Shkolla e Drejtorëve ka të drejtë të gjejë dhe zbatojë zgjidhjet ligjore, financiare, logjistike, etj., siç gjykohen të përshtatshme nga Shkolla e Drejtorëve për të mundësuar që trajnimi të kryhet në standarde ligjore e bashkëkohore.
- Shkolla e Drejtorëve përgatit kurrikulat e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikim.
- Shkolla e Drejtorëve përgatit planet e trajnimit dhe për zgjedh kandidatët, të cilët do të trajnohen nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
- Shkolla e Drejtorëve përgatit kërkesat specifike që duhet të ketë infrastruktura arsimore në shërbim të trajnimit të drejtorëve/nëndrejtorëve të arsimit parauniversitar.
- Shkolla e Drejtorëve ka të drejtën të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme vijueshmërinë e menaxhimit nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë të programit të trajnimit.
- Shkolla e Drejtorëve kur vëren se Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë nuk përmbush detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ka të drejtë të ndërpresë menjëherë Marrëveshjen duke njoftuar palën.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, merr përsipër :

- Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, angazhohet të marrë të gjitha masat për dhënien në përdorim të Infrastrukturës Arsimore dhe Pajisjeve, sa herë i kërkohet nga Shkolla e Drejtorëve dhe në çdo kohë, bazuar në këtë Marrëveshje.
- Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë angazhohet të japë në përdorim pa pagesë Infrastrukturën Arsimore, klasë /auditor Nr. **B216** dhe Pajisjet sipas rregullave përkatëse të zbatueshme dhe pa ndërprerje duke mos cënuar procesin normal të trajnimit të drejtorëve/nëndrejtorëve.
- Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë pranon zgjidhjet ligjore të ofruara nga Shkolla e Drejtorëve për vënien në dispozicion të Infrastrukturës Arsimore të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë të cilat respektojnë kuadrin ligjor përkatës.
- Menaxhimi i stafit akademik të UniVLORA, të kontraktuar nga Shkolla e Drejtorëve, do të bëhet nga Koordinator i Programit të Trajnimit, i cili emërohet nga Shkolla e Drejtorëve.
- Për efekte të zbatimit të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë pohon në këtë Marrëveshje se Shkolla e Drejtorëve nuk është institucion i arsimit të lartë.
- Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë angazhohet të raportojë pranë Shkollës së Drejtorëve për çdo incident që mund të ndodhë gjatë zhvillimit të programit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Stafi akademik i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, i trajnuar dhe kontraktuar nga Shkolla e Drejtorëve është i angazhuar të realizojë me sukses modulën e dakorduar në kontratën e shërbimit përkatëse të lidhur midis Shkollës së Drejtorëve dhe Trajnerit/ëve përkatës.
- Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka përgjegjësi për mbrojtjen sipas standardeve të kërkuara nga legjislacioni i zbatueshëm të të dhënave personale të drejtorëve/ nëndrejtorëve aktualë dhe aspirantëve për drejtorë të IAP për të cilat Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë merr dijeni gjatë dhe për shkak të lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, motit të keq, “Fuqisë Madhore” ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t’i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6 Mirëbesimi

- 1.Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe Qendrës “ Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar” do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë.
2. Palët duhet të rruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje

Neni 7 Afati i marrëveshjes

- 1.Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje nga data 17.10.2025 deri 27.06.2026 e nënshkrimit.
- 2.Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
- 3.Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me Shkrim Palës tjetër, të paktën 6(gjashtë) muaj përpara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 8
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 2(dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1(një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe 1 (një) kopje do të depozitohet në Qendrën "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar".

PËR

UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR
PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

QENDRA
"SHKOLLA E DREJTORËVE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

DREJTOR EKZEKUTIV
JOLA KEPI

